



Pranuar / Dorezuar Prilimenc/Prodato Received/Delivered	24.12.2021	viti god year	2021
Organ /Njësia Organ /Jednica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKM/SH/OK	6346/2021		1/5



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A. Nr.984/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Jeton Koca dhe Arben Mehmeti, anëtarë, me Sabile Avdyli, Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësi të procesmbajtëse, sipas Aktgjykimit A.nr.14/20 të datës 01.12.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.602/2019 të datës 03.10.2019, të parashtruar nga ankuesja me adresë banimi: Rr."Mithat Frashëri",Nr.18, Mitrovicë, kundër organit të punësimit Gjykata Themelore në Mitrovicë në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 24.12.2021, mori këtë .

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.602/2019 e datës 03.10.2019, e parashtruar nga ankuesja.
- II. Mbetet në fuqi Vendimi KA.nr.07/2019 i datës 29.08.2019, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Mitrovicë, me datë 30.05.2019 ka shpallur konkursin e jashtëm për pozitën e punës "Zyrtar për Informim dhe Monitorim të Mediave", e në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesja Organi i punësimit bazuar në përmbledhjen e vlerësimeve të anëtarëve të Komisionit Përzgjedhës, i themeluar me Vendimin GJA:146/2019 të datës 17/06/2019, me datë 04.07.2019 ka shpallur njoftimin për kandidatin përzgjedhës

Ankuesja e pakënaqur me mos përzgjedhjen e saj sipas Njoftimit të datës 04.07.2019, me datë 05.08.2019 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave pranë Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Ky i fundit me Vendimin KA.nr.07/2019 të datës 29.08.2019, ka refuzuar ankesën e ankueses si të pabazuar.

Ankuesja kundër vendimit KA.nr.07/2019 të datës 29.08.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, më datë 03.10.2019 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 4641/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 15.11.2019 përmes shkresës me numër të protokollit 5178/2019, ka njoftuar ankuesen për pamundësinë e vendosjes lidhur me ankesën e saj të datës 03.10.2019, duke udhëzuar te njëjtën që ti ndjekë më tutje procedurat ligjore. Ankuesja ka parashtruar padi me datë 06.01.2020 pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative kundër heshtjes së Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative me datë 26.11.2021 ka nxjerrë Aktzërvikimin me numër A.nr.14/202, me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses ka anuluar Njoftimin e KPMSHCK-së të datës 05.11.2019 dhe detyron të njëjtin që në afat prej tridhjetë (30) ditësh të vendos lidhur me ankesën e paditëses të datës 03.10.2019.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 4641/2019 të datës 03.10.2019 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Cv-ne e ankueses; Kopja e konkursit e datës 30.10.2018 me nr.11/2018; Përgjigjen në ankesës e datës 17.10.2019; Regjistri i aplikacioneve të pranuar prej datës 06.06.2019; Vendimin A.nr.07/2019 i datës 29.08.2019 me numër protokollit 675 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës; Kopjen e konkursit të datës 30.05.2019 me nr.1/2019; Listën e selektimit të ngushtë të datës 19.06.2019; Kopjen e testit me shkrim e ankueses dhe kandidatit përzgjedhës i datës 28.06.2019; Vlerësimet individuale të kandidatëve; Kërkesën për punësim e datës 11.06.2019 për pozitën Zyrtar për Informim dhe Monitorim të Mediave për bashkë me dokumentet e kërkuara; Kopjen e testit me shkrim të datës 28.06.2019; Testin me shkrim në gjuhën serbokroate të datës 28.06.2019 për Formularët e vlerësimit individual nga anëtarët e Komisionit Përzgjedhës për Formularët e vlerësimit individual nga anëtarët e Komisionit Përzgjedhës për Kërkesën për punësim të datës 12.06.2019 për pozitën Zyrtar për Informim dhe Monitorim të Mediave për bashkë me dokumentet e kërkuara; Diplomën e Fakultetit Juridik të datës 31.01.2013 Nr.655 të lëshuar nga Universiteti "Sv.kiril i Metodij" në Shkup; Vendimin e datës 25.04.2014 me Nr.6/2601 të lëshuar nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë; Komunikimin në Krizë dhe marrëdhëniet me publikun me datën 10.04.2007; Mirënjohje për punë të suksesshme si praktikant e vitit 2004; Certifikatën e datës 17.06.2019; Certifikatën e datës 12.06.2019; Certifikatën e datës 13.07.2019; Certifikatën e datës 11-15.06.2007; Certifikatën e datës 06-07.02.2008; Pasqyrën e llogarisë së trustit për prej datës 01.08.2002 deri me datën 16.11.2018; Certifikatën e datës 11.06.2019 të lëshuar nga Gjykata Themelore në Mitrovicë; Kopja e letërnjoftimit; Certifikatën e datës 26.09.2006; Vërtetimin e datës 21.10.2009; Certifikatën e datës 21.09.2008; Kontratën e datës 10.05.2010; Diplomën e Fakultetit Juridik të datës 27.03.2003 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës; Certifikatën e datës 04.10.2012; Certifikatën e datës 12.12.2014; Diplomën e muajit tetor 2008 dhe qershor 2009; Certifikatën e muajit mars-qershor 2010; Vlerësimin i punës për prej datës 16.03.2015 deri më

31.08.2015; Rekomandim e datës 14.08.2012; Marrëveshjen për Shërbime të veçanta të datës 23.03.2015 deri më datën 31.08.2015; Përshkrimin e vendit të punës; Përgjigjen e datës 10.09.2014 nga Agjencia Kundër Korrupsionit; Njoftimin e kandidatëve për mbajtjen e intervistës 01.07.2019; Përmbledhjen e vlerësimeve individuale të datës 03.07.2019; Listën e kandidatëve për listën e ngushtë; Njoftimin e datës 05.11.2019 me numër protokoll 5178/2019, Aktgjykimin A.nr.14/20 të datës 01.12.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative dhe Përgjigjen në ankesë të datës 18.10.2019.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, konstatoi se ankesa e ankueses *është e pabazuar, sepse:*

Ankuesja në ankesën e ushtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, pretendon që Gjykata Themelore e Mitrovicës ka zhvilluar procedurën e rekrutimit për pozitën "Zyrtar për Informim dhe Monitorim të Mediave", në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

Sipas konkursit me nr.1/2019 të datës 30.05.2019, kritere themelore për pozitën "Zyrtar për Informim dhe Monitorim të Mediave" janë përcaktuar: *Diplome Universitare-Marrëdhënie me publikun, gazetari, fakulteti juridik, filologjik apo filozofik; Minimumi dy (2) vite përvojë pune në fushën përkatëse apo të ngjashme.*

Lidhur me pretendimin ankimor se ankuesja ka qenë kandidati me meritë për këtë pozitë, Kolegji bazuar në shkresat e lëndës ka konstatuar se kandidati i përzgjedhur sipas Diplomës me Nr.655 të datës 31.01.2013 të lëshuar nga Universiteti "SV.kiril i Metodij" në Maqedoni, e nostrifikuar nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë përmes Vendimit nr.06/2601 të datës 25.04.2014, ka përfunduar Studimet në Fakultetin Juridik duke marrë titullin "Politolog i diplomuar", ndërsa lidhur me përvojën e punës gjegjësisht sipas Pasqyrës së Trustit Pensional, Kolegji ka konstatuar se kandidati ka përvojë punë pas diplomimit dhe atë: përkthyes i gjuhës serbokroate në Ministrinë e Administratës Publike për periudhën kohore nga marsi 2008 deri nëntor 2015, si dhe në Ministrinë e Financave për periudhën nga dhjetori 2015 deri nëntor 2019, andaj, bazuar në këtë konstatim Kolegji vlerëson se kandidati i përzgjedhur ka përmbushur kriteret e Konkursit për pozitën Zyrtar për Informim dhe Monitorim të Mediave.

Përkitazi me pretendimin ankimor se Komisioni Përzgjedhës ka pasur tre anëtarë të komunitetit serb dhe vetëm dy shqiptarë, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi që ka analizuar Vendimin GJA:146/2019 të datës 17/06/2019 për themelimin e Komisionit Përzgjedhës për Shërbimin Civil për pozitën Zyrtar për Informim dhe Monitorim të Mediave, ka konstatuar se përbërja e Komisioni Përzgjedhës është në pajtim me nenin 7 paragrafi 1 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil i cili përcakton se: *"Institucionet themelojnë një Komision Përzgjedhës ad hoc të Shërbimit Civil(në tekstin në vijim: KPSHC), i cili zhvillon procedurat e rekrutimit. KPSHC përbëhet nga anëtarë të cilët kanë pozita më të lartë se pozita që duhet të rekrutohet , por një anëtarë mund të ketë pozitën e njëjtë, të jetë shumetnik dhe me përfaqësim gjinor..."* e mbi këtë bazë rrjedhë se pretendimi i ankueses është i pa bazuar.

Nga vlerësimi i shkresave të lëndës gjegjësisht sipas listës përmbledhëse të vlerësimeve të Komisionit Përzgjedhës, Kolegji ka gjetur së kandidati është vlerësuar si kandidati më shumë pikë me gjithsej 428.5 pikë, ndërsa ankuesja është renditur si kandidata e katërt me gjithsej 341.5 pikë, dhe si rrjedhojë Kolegji vlerëson se Komisioni Përzgjedhës ka vepruar në pajtim me nenin 40 paragrafin 1 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, me të cilin është përcaktuar se: *“Në Shërbimin Civil emërohen kandidatët, të cilët kanë arritur numrin më të madh total të pikëve në testimin me shkrim dhe me gojë”*.

Po ashtu, përkitazi me pretendimin ankimor të ankueses së testi me shkrim ka qenë në kundërshtim me nenin 36 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, me arsyetimin se testi është përpiluar edhe në gjuhën serbokroate dhe se njëkohësisht i njëjti i është dorëzuar paraprakisht kandidatit përzgjedhës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave nga analizimi i shkresave të lëndës vlerësoj se testi me shkrim është përgatitur në pajtim me kërkesat ligjore të përcaktuara me dispozitat e nenit 36 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil dhe Ligjit Nr. 02/L-37 për Përdorimin e Gjuhëve Zyrtare në Kosovë dhe se me asnjë prove nuk vërtetohet fakti se kandidati i përzgjedhur N.H, ka qenë i njoftuar paraprakisht me përmbajtjen e testit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e ankesave pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore dhe të gjitha shkresave të lëndës, ka konstatuar se procedura e rekrutimit për pozitën e punës “Zyrtar për Informim dhe Monitorim të Mediave”, në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, është zhvilluar në pajtim me nenin 11 paragrafin 1 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil, ku përcaktohet se: *“11.1 Pranimi në Shërbimin Civil të Kosovës bëhet në pajtim me parimet e meritës, aftësisë profesionale, paanshmërisë, mundësive të barabarta, mos diskriminimit dhe përfaqësimit të barabartë, në bazë të konkursit publik dhe pas verifikimit të zotësisë së veprimit të kandidatëve.*

Andaj, bazuar si me lartë, konstatohet se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Gjykatës Themelore në Mitrovicë, me rastin e nxjerrjes së Vendimit KA.nr.07/2019 të datës 29.08.2019 ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike duke vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Rregulloren Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave.

Kështu qe, duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hynë në fuqi ne ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.984/2021

Jabile AVDYLI

Jabile Avdyli
Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj Dem

Ardita Haxhnikaj Dem
Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet

- Ankueses
- Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative;
- Kryetarit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë;
- Udhëheqësit të Personelit në Gjykatën Themelore në Mitrovicë dhe;
- Arkivit të KPMSHCK-së.

